

VENDIM
Nr.433, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “ROT”
(REHABILITIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “ANSARA” SHPK,
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “LABINOT MAL–ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “ROT” (rehabilitim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Ansara” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Labinot Mal–Elbasan”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha